



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 22 MARS 2019**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 22. MARTA 2019. GODINE**

**MARS - MART
2019**

Rendi i ditës

1. Miratimi i rezolutës lidhur me pezullimin e aktivitetit të kazinove dhe lojërave të fatit dhe plotësim-ndryshimin e ligjit përkatës

Dnevni red

1. Usvajanje rezolucije o obustavi aktivnosti kazina i igara na sreću i izmena i dopuna odgovarajućeg zakona

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme, me kërkesë të 49 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Do ta konstatojmë praninë për 2-3 minuta. Procedojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Miratimi i propozim-rezolutës lidhur me pezullimin e aktiviteteve të kazinove dhe lojërave të fatit dhe plotësim-ndryshimi e ligjit përkatës

Të nderuar deputetë,

49 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me miratimin e propozim-rezolutës lidhur me pezullimin e aktiviteteve të kazinove dhe lojërave të fatit dhe plotësim-ndryshimi e ligjit përkatës.

E ftoj zotin Avdullah Hoti që në emër të propozuesit ta paraqesë dhe arsyetojë propozim-rezolutën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Vrasja tragjike e dy të rinjve në vendin e tyre të punës na ka prekur të gjithëve. Edhe një herë ju shpreh ngushëllime familjeve dhe miqve të tyre. Është bërë e qartë fatkeqësisht në mënyrë tragjike se lojërat e fatit janë ambiente ku dëmtohen, dhunohen dhe vriten qytetarët. Është po ashtu e qartë se këto raste nuk janë të izoluara.

Krimi, dhuna, shkatërrimi i familjeve, humbja e pasurisë, prishja e qetësisë publike janë efektet e vetme ekonomike dhe sociale të këtij sektori. Askush nuk pasurohet nga këto bizneseve, përveç pronarëve të tyre të njohur e të panjohur. Jam i sigurt se askush nga ju nuk e njihni një person të vetëm në Kosovë që është bërë i pasur nga lojërat e fatit. Pra, këto nuk janë lojëra të fatit, por janë lojëra të zhvatjes së qytetarëve.

Shteti i Kosovës është përgjegjës t'i mbrojë qytetarët, por është për keqardhje që vetëm pas ngjarjeve të tilla tragjike nxitet reagimi institucional për t'u marrë me këto çështje.

Më lejoni të jap disa të dhëna, që dokumentojnë funksionimin e këtij sektori plotësisht jashtë ligjit.

Sot, sipas të dhënave publike të Doganës, në Kosovë funksionojnë 1 645 aparate të licencuara të lojërave të fatit. Për ilustrim, Kosova ka 1 469 vendbanime, që i bie së paku një aparat i lojërave të fatit për çdo vendbanim në Kosovë. Përveç këtyre, në Kosovë funksionojnë 294 bastore të licencuara. Ndërkaq, të dhënat nga Dogana për 2018 tregojnë se ka pasur 185 raste të shqiptimit të gjobave për pika të bastoreve të palicencuara. Kjo nënkupton që ka gati dyfish më shumë bastore sesa që janë të licencuara. Administrata Tatimore më 2018 ka mbyllur 301 lokale të lojërave të fatit dhe ka shqiptuar 700 gjoba.

Të gjitha këto të dhëna tregojnë qartë se ky sektor, në masën më të madhe, është duke funksionuar jashtë ligjit.

Të hyrat doganore gjatë vitit 2018 nga licencat e lojërave të fatit kanë qenë 16 milionë euro. A duhet që ne ta shndërrojmë Kosovën në kazino për të mbledhur këta 16 milionë euro, ose dyfishin e këtyre mjeteve në rast se formalizohet plotësisht ky sektor? Ta keni të qartë se këto 16 milionë euro janë të ardhurat e fundit të familjeve, të cilat pastaj na kthehen në familje që varen nga asistenca sociale, në familje me probleme të dhunës, ku fëmijët e humbin fëmijërinë e tyre.

Të nderuar deputetë,

Më 11 dhjetor 2018, Qeveria e Kosovës e ka miratuar Koncept-Dokumentin për Lojërat e Fatit, ku parashihet promovimi i këtij sektori si mundësi për zhvillim ekonomik, të ardhura dhe punësim, si dhe rritje të buxhetit të shtetit. Por, ajo që dihet për këto biznese është se plot familje në Kosovë kanë humbur gjithçka që kanë për shkak të varësisë nga lojërat e fatit. Në vend se të kontrollohen e të ndëshkohen për shpërdorime, kazinotë janë shtuar nëpër të gjitha vendbanimet. Janë raportuar vetëvrasje si rezultat i humbjes së pasurisë në lojërat e fatit, sepse në kazinotë në fakt luhet vetëm me fatin e njerëzve. Në kazinotë e Kosovës me fat janë vetëm mashtruesit.

Me gjithë këto ngjarje tragjike që lidhen me këto biznese, shteti nuk mund ta përmirësojmë imazhin e këtij sektori, siç pretendon të bëjë Qeveria me këtë koncept-dokument që e përmenda më lart.

Ne nuk mund t'i varim shpresat për rritje të buxhetit te zvogëlimi i informalitetit dhe rritja e qarkullimit në këtë sektor, siç pretendon të bëjë Qeveria me këtë koncept-dokument. Është e mjerë në fakt ajo Qeveri dhe çfarëdo qeverie tjetër që shpreson në rritje të buxhetit nga lojërat e fatit. Vetëm një Qeveri me mentalitet kazinoje mund të paramendojë diçka të tillë.

Prandaj, të nderuar deputetë, duhet të marrë fund mentaliteti politik që i favorizon kazinotë dhe lojërat e fatit, si formë e zhvillimit ekonomik, e punësimit dhe e të ardhurave. Këtë qasje duhet ndaluar urgjentisht, sa nuk është kthyer krejt Kosova në një kazino, ku humbës jemi të gjithë ne. Nuk duhet të lejojmë që kazinotë ta ushqejnë krimin. Nuk duhet të lejojmë që lojërat e fatit ta përcaktojnë fatin e individëve dhe të familjeve tona. Si deputetë të Kuvendit të Kosovës, e kemi

obligim që ta adresojnë me urgjencë këtë fenomen. Mosveprimi sot i institucioneve do të rezultojë me më shumë krim e pasoja, dhe do ta vështirësojë adresimin e këtij problemi më vonë.

Prandaj, në emër të deputetëve nënshkrues të kërkesës për këtë seancë, kërkoj që Kuvendi i Kosovës, në mbështetje të nenin 65.1 të Kushtetutës dhe nenit 44, paragrafi 4, pika (d), të Rregullores të Kuvendit, të miratojë këtë rezolutë me dy pika:

1. Qeveria menjëherë të pezullojë aktivitetin e të gjitha llojeve të kazinove dhe lojërave të fatit deri në plotësim-ndryshimin e ligjit përkatës dhe

2. Kuvendi ta mandatojë Komisionin Parlamentar për Buxhet dhe Financa që t'i nisë procedurat për nxjerrjen e ligjit të ri dhe brenda një muaji ta sjellë ligjin e ri në Kuvend, i cili i ndalon të gjitha llojet e kazinove dhe lojërave të fatit për një periudhë dhjetëvjeçare.

Kërkoj nga të gjithë deputetëve ta mbështetin këtë rezolutë.

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Gjithashtu kërkoj që duke pasur parasysh ndjeshmërinë e situatës pas vrasjes së dy të rinjve, të mos ketë debat parlamentar për këtë rezolutë. Kështu që në përputhje nenin 50.1, pika d e Rregullores së Kuvendit, kërkoj që menjëherë të votohet ky mocion dhe pastaj të nxirret rezoluta në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani janë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës e përfundoi, atëherë Memli Krasniqi, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ne edhe dje në konsultimet e përbashkëta dhe me kolegë nga grupet tjera parlamentare jemi dakorduar që ta mbështetim edhe thirrjen e kësaj seance të jashtëzakonshme, edhe tekstin e rezolutës së propozuar, duke pasur parasysh ngjarjet tragjike të ditëve të fundit dhe po ashtu edhe diskutimet publike në lidhje me këtë çështje gjatë gjithë këtyre muajve.

Meqenëse tashmë propozuesi e lexoi draftin e rezolutës, unë edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e shpreh mbështetjen për këtë tekst, duke shpresuar që kjo rezolutë të implementohet menjëherë ashtu siç kërkohet, dhe e dyta, po ashtu, e mbështetim mocionin që të kalohet drejtpërdrejt në votim të rezolutës pa pasur debat në respekt të ngjarjeve tragjike që kanë ndodhur gjatë kësaj jave, dy vrasjeve në dy kazino, në dy qytete të ndryshme të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca nga Lëvizja Vetëvendosje.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Edhe pse me vonesë, është mirë që po flasim për këtë temë, mirëpo ana e keqe është që ne po flasim vetëm kur njerëzit po e humbin jetën. Kur po argumentojmë më herët që këto aktivitete, prapa të cilave mund të fshihen edhe veprimtari të dyshimta, edhe të lidhura me krimin e organizuar, sa herë që po i ngremë këto tema, institucionet relevante po i marrin pa seriozitet, dhe puna po shkon deri aty sa njerëzit edhe ta humbin jetën, siç ndodhi në dy raste gjatë ditëve të fundit në Kosovë.

Sa i përket këtij lloji të veprimtarive, ka hulumtime kredibile që disa prej këtyre kazinove dhe lojërave të fatit shërbejnë në Kosovë për shpëlarjen e parave. Pra, një veprimtari e tillë është e lidhur drejtpërdrejt me funksionimin e krimit të organizuar në Kosovë, përpos në industrinë e ndërtimit, njëra prej mënyrave më të sigurta për t'i shpëlarë paratë në Kosovë është nëpërmjet lojërave të fatit, kjo është e para. E dyta, në Kosovë ka qindra kazino që punojnë pa licencë, edhe Qeveria ose e di, ose nuk e di, po nëse nuk e di e ka përgjegjësinë e drejtpërdrejtë, sepse nuk i ka nën kontroll, e nëse e di edhe më keq. Mbyll sytë dhe ato funksionojnë. Tjetra? Kazino në Kosovë ka në 100 metra, për të mos thënë edhe ngjitur me shkolla. Ka kazino ngjitur me çerdhe, me institucione shkollore, afër institucioneve fetare, afër xhamive, afër institucioneve fetare, me ç'rast janë drejtpërdrejt në shpërputhje me ligjin, i cili e thotë qartë se qysh është e rregulluar kjo fushë. Duhet një hetim i gjithanshëm edhe nga Policia, e pastaj për të shkuar në procedura të Gjyqësorit. Si është e mundur të ketë qindra kazino në Kosovë, të cilat kanë licencë, kanë arritur ta marrin licencën afër shkollave, çerdheve dhe afër institucioneve fetare në kundërshtim me ligjin?

Kjo në këtë prapavijë është indikator i qartë që ekziston një korrupsion, të cilin vetëm duhet hetuar, sepse ai kapet ai korrupsion, por këtu nuk ka vullnet për ta hetuar. Prej nga vjen frika e Gjyqësorit për të mos e hetuar këtë korrupsion, unë nuk e di. Mirëpo kjo është shenjë e keqe, sepse një prokuror nuk guxon ta hetojë këtë çështje vetëm nëse frikësohet që kazinotë e tilla janë të lidhura me njerëz, të cilët janë të fuqishëm në pushtet. Unë arsye tjetër nuk di pse nuk hetohen këto raste. Ka me dhjetëra e dhjetëra raste kur kazinotë e licencuar janë të kapura me shkollat janë. Nuk e di qysh ta shpjegoj më qartë për ta ndalë atë kazino. Ajo është edhe në shpërputhje me ligjin. Unë nuk po flas qysh ky aktivitet në përgjithësi është i gabueshëm edhe është mirë të ndalet, por unë po flas në raport me ligjet, për të cilat e kemi ngrehur dorën këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës, e janë në shpërputhje me ato.

Pastaj, ky koncept-dokumenti që e ka prodhuar Qeveria që për kazinotë, është i mjerueshëm edhe skandaloz. I kisha bërë thirrje Qeverisë për ta hequr atë dokument prej ueb-faqes. Ju lutem! Në atë dokument shkruan që papunësia ulet nëpërmjet kazinove. Ky është koncepti ekonomik i Qeverisë së Kosovës për papunësi në Kosovë. Domethënë, papunësia nuk ulet duke e zhvilluar

ekonominë, duke i mbështetur bizneset, duke promovuar hapjen e vendeve të reja të punës në këtë mënyrë prej mbështetjes së bujqësisë e deri te industria, por njëra prej ideve gjeniale të kësaj qeverie është që papunësia po u ulka nëse këtu ka sa më shumë lojëra të fatit dhe kazino.

Tjetra? Në koncept-dokumentin e Qeverisë shkruan që, kjo është me të vërtetë për të të ardhur gjynah, shkruan që kazinotë e ndalin edhe dhunën në familje. Kush ka mundur ta shkrujë këtë fjali, sikur ta dija! Kush është ai ekspert që arrin deri te një konkludim i tillë, që kazinotë po e ndalcan dhunën në familje. A di çka kallëzon kjo? Kjo kallëzon çfarë koncepti ka Qeveria për familjen. Ai që e ka shkruar këtë fjali mendon që dhuna në familje është rrezik të ndodhë kur njerëzit rrinë bashkë në familje, kështu që burri duhet të dalë e të shkojë në kazino, sepse kjo e ndal dhunën në familje. Ashtu është kuptimi i kësaj, nëse e lexon këtë fjali. E, çka i ndodh atij djalit, ai shkon në kazino dhe e humb jetën. Domethënë ik prej dhunës në familje dhe po e humb jetën në kazino. Kështu janë konceptet e Qeverisë!

Nëse ky dokument është i Qeverisë, ai dokumenti për kazinotë që e ke në ueb-faqe të Qeverisë, atëherë ju lutem hiqeni atë dokument prej ueb-faqes sa më shpejt që të jetë e mundur, sa jemi ne duke folur këtu bile duhet të hiqet ai dokument. Kështu që kjo është edhe arsyeja pse Vetëvendosja së bashku me LDK-në dhe deputetët tjerë e kanë nënshkruar këtë, i ka vënë nënshkrimet për thirrjen e kësaj seance, e cila do të ishte mirë të përmbylej me këtë rezolutë.

Rezoluta edhe e kërkon ndryshimin e ligjit, edhe e kërkon mbylljen e kazinove për një periudhë 10-vjeçare. Kjo është e domosdoshme për vendin tonë që të ndodhë. Faleminderit!

KRYETARI: Faton Topalli, në emër të Partisë Socialdemokrate, urdhëroni!

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuara kolege dhe kolegë të Kuvendit të Republikës.

Meqë më është kërkuar nënshkrimi im nga kolegët dhe koleget e mia të opozitës për këtë debat parlamentar, kam nënshkruar së bashku me deputetët tjerë të Partisë Socialdemokrate. Këtë e kemi bërë nga njëra anë për ta përsëritur qëndrimin e PSD-së se është shumë e interesuar që të ketë bashkëpunim të ngushtë me opozitën dhe, në anën tjetër, për ta trajtuar temën pse është ftuar ky debat dhe nëpërmjet kësaj për ta shprehur mendimin tonë, edhe timin, se në fakt çfarë do duhej të bënim si një opozitë e bashkuar në rrethanat aktuale, në të cilat gjendemi.

Më lejoni që në fillim të fjalës sime, për të mos pasur keqkuptime për ato që do të them më vonë, të deklaroj se Partia Socialdemokrate është për pezullimin e aktiviteteve të lojërave të fatit. Pra, e mbështetim këtë iniciativë. Në këtë çështje nuk kemi asnjë dilemë. Uroj që edhe ju që e iniciuat këtë debat ta keni seriozisht.

Propozuesit e debatit e kanë ftuar këtë seancë për shkak se brenda një kohe të shkurtër kanë ndodhur dy vrasje në lokalet e kazinove dhe se sipas tyre ekziston rreziku që rastet e tilla të shndërrohen në fenomen. Me fjalë tjera, ka rrezik që në kazino të ketë më shumë vrasje, prandaj kërkohet nga Qeveria e Kosovës që ta pezullojë punën e kazinove.

Në fakt, ne nuk e dimë saktësisht pse kanë ndodhur vrasjet. Ajo që dimë është se vendi i vrasjes janë dy kazino. Në fakt, thelbi i problemit që ngre propozuesi nuk janë lojërat e fatit, nuk është Ligji për lojërat e fatit, nuk është ndryshimi i tij, nuk janë pasojat fatale të varësisë nga lojërat e fatit, por aspekti i sigurisë fizike të qytetarëve, e ky aspekt s'ka të bëjë gati fare me lojërat e fatit. Ky tekst që keni dorëzuar ju, për ta bërë më të kuptueshëm për secilin qytetar, thotë: Kazinotë janë vende ku mund të vriten qytetarët, prandaj duhet të ndalohen. Po mirë, kolegë e kolege të nderuar, nëse e ndjekim këtë logjikë, pra bankat janë vende ku ka pasur vrasje, a duhet të ndalohen ato? Kafenetë dhe restorantet ku pihet verë, rakia e duhani, droga e të tjera, ku ka pasur vrasje me armë, a duhet të ndalohen?

Po 92 punëtorë që e humbën jetën në punishtet e ndërtimit, a duhet ta ndalojmë ndërtimin? Rrugët e Kosovës në të cilat shoferët e papërgjegjshëm ua marrin jetën të tjerëve, a duhet t'i ndalojmë rrugët? Me këtë dua të them që rreziku për jetën nuk është vendi i krimit, pra kazinotë nuk janë vende të rrezikshme për jetë për shkak se kanë ndodhur kohëve të fundit dy vrasje brenda tyre, e ndoshta mund të ndodhin dhe të tjera. Propozuesi thotë se ka rrezik që vrasjet të kthehen në fenomen. Nuk e di nëse është përdorur kjo fjalë rastësisht, sepse dy vrasje nuk janë fenomen. Kazinotë janë të rrezikshme për shkak të varësisë që mund të shkaktojnë lojërat e fatit. Pra, ky është rreziku kryesor i kazinove dhe lojërave të tjera të fatit dhe jo lokalet ku janë vendosur ato.

A e dini cila është politika më e mirë kundër kriminalitetit, kundër plaçkitjes së bankave, kundër plaçkitjes së kazinove, kundër vjedhjeve nëpër shtëpi, kundër lojërave të fatit? A e dini, zoti Hoti, cilat janë politikat më të mira? Politika më e mirë kundër kriminalitetit, kundër dhunës, kundër plaçkitjeve, kundër lojërave të fatit është politika sociale, për të cilën ne sot nuk po bisedojmë.

Tani unë nuk e di motivacionin e saktë të propozuesve për thirrjen e këtij debati, por nisem nga hipoteza se debati është i singertë dhe ka për qëllim trajtimin e temës për çfarë thotë se është thirrur. Në këtë çështje, unë shoh dy gabime. E para debati është huq fare si shpjegim, sepse thotë se ka të bëjë me lojërat e fatit, por në fakt shtrohet çështja e sigurisë.

Këtë më shumë po ia lë mungesës së njohurive dhe panikut që si opozitë, përkundër fuqisë parlamentare, keni mbetur në bisht të ngjarjeve. Gabimi i dytë është reagimi spontan për një problem që nuk është i ri, problemi i kazinove dhe lojërave të fatit është problem i vjetër. Së paku zoti Hoti ka qenë tri vjet ministër i Ekonomisë, ministër i Financave, dhe tregoi edhe këtu

në diskutimin e tij se i njeh saktësisht shifrat dhe që e njeh problemin. Unë më shumë do ta shtroja pyetjen pse gjatë kohës kur ishte ministër dhe në Qeveri, meqë e njihje kaq mirë gjendjen, nuk e shtroi këtë çështje? Por, megjithatë, më mirë vonë se kurrë.

Me fjalë të tjera, jemi tubuar kot dhe ky është problemi kryesor i një opozite të fuqishme në numra, që prodhon seanca kot, rezoluta kot dhe kritika kot, drejtuar Qeverisë, pa u përpjekur asnjëherë seriozisht për ndryshimet pozitive gjatë të qenët opozitë, që shkojnë në të mirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Sikur propozuesit ta dëshironin një ndryshim të mirëfilltë, ata së bashku me ne, që edhe ashtu e kemi pasur në plan, do të takoheshin dhe do të vendosnin ta merrnin një vendim të përbashkët për ta suspenduar krejtësisht ligjin, apo për ta ndryshuar atë.

Ju e dini që për ndryshime të caktuara ligjore nuk ka nevojë për 40 nënshkrime sa janë mbledhur, por mjaftojnë 6 nënshkrime. Kemi pra reagime spontane ndaj situatës, por nuk kemi politika të mirëfillta. Ajo që do të duhej të ishte konstante, është ligji i cili e ka parasysh lojën e fatit si aktivitet të kohëpaskohshëm të lirë, aspektin e varësisë si problem kryesor, por edhe trajtimin e tyre medicinal, masat konkrete, si për shembull ndalimin e aktiviteteve propagandistike ekonomike për lojëra të fatit, reklamat në qytet, e një varg gjërash të tjera.

Ky reagim spontan do ta prodhojë eventualisht një rezolutë, e cila do të përmbajë ndoshta ca rreshta të formuluar mirë, e cila nën një nuk është obligative për Qeverinë dhe e dyta nuk do ta ketë ndoshta asnjë efekt pozitiv për temën për të cilën është thirrur për shkak se vetëm ndryshimi i ligjit mund të ketë pasoja pozitive. Pra, nëse bash e shikojmë nga aspekti i efektivitetit, pra se çfarë dobie do të kemi, jo vetëm nga ky, por edhe nga debate të tjera të tilla spontane, atëherë po e them me siguri të plotë, asgjë më shumë se një aktivitet në agjendat tona partiake. Do të shtyhem ndoshta pak me njëri-tjetrin, ndoshta mediat do ta publikojnë ndonjë deklaratë pak a shumë ekstreme, sepse në vendin tonë çështjet konstruktive nuk janë interesante, por kaq dhe asgjë më shumë.

Do të ishte krejt ndryshe nëse Lidhja Demokratike e Kosovës së bashku me deputetët e partisë së Albin Kurtit të na ftonte për nënshkrime, jo vetëm për nënshkrime, por të uleshim bashkërisht dhe me forca të përbashkëta ta ndërmerim një nismë ligjore, e cila do të ishte fundamenti i këtij debati, por jo vetëm me deklaratata, të cilat janë këtë herë të kota, e që nuk e kanë asnjë obligim për Qeverinë. Faleminderit!

KRYETARI: Ahmet Isufi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Rezoluta është shumë e saktë. I ka dy pika që duhet të votohen dhe janë për pezullimin e menjëhershëm të kazinove dhe lojërave të fatit dhe njëkohësisht angazhimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që brenda muajit ta nxjerrin Ligjin e ri, i cili i ndalon për dhjetë vjet këto ndërmarrje, të cilat vërtet edhe bëjnë varfërimin e qytetarëve të Kosovës, edhe kanë kaluar edhe në tragjedi familjare, siç janë dy rastet që u përmendën.

Ne e kemi edhe sinjalin nga komunat ku kanë ndodhur ngjarjet, menjëherë kanë filluar petitionet. Në Suharekë, në Lipjan, e po ashtu është përkrahur dhe komunat tjera. ku po ashtu e kanë filluar përkrahjen. Kuvendi është ftuar menjëherë që ta aprovojme këtë rezolutë dhe unë konsideroj se debatet tjera, duke ditur se në çfarë përmasash kanë kaluar këto ndërmarrje, duhet të ndërpriten menjëherë dhe të aprovet rezoluta, në mënyrë që ligji sa më shpejt të nxirret dhe të krijohet një rregull në sistemin e shoqërisë sonë.

Po ashtu, u përmendën dobësitë e institucioneve të kaluara, se sigurisht sikur të ishin kryer inspektimet e duhura, sikur t'i ishin përmbajtur ligjit dhe të ishin zbatuar ligjet ashtu si duhet, unë besoj se nuk do të ishim ardhur në këtë gjendje, por megjithatë më e mira është që tani të bëhet ndalimi i tyre dhe të kalojmë në aprovimin e një ligji, ku bëhet një rregull në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë po u referohem kush po e kërkon fjalën. Nga grupet parlamentare, Bilall Sherifi, Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritje të nderuar kolegë!

Gjithsesi që Nisma, sikur të gjitha grupet parlamentare, do ta mbështesë këtë iniciativë për ta kaluar këtë rezolutë me qëllim që pastaj Qeveria të ndërmarrë hapat e nevojshëm, por ndiej obligim të them se këtu doli nga marrëveshja që të mos shtrihet tema në debat për deputetët tjerë, por edhe kolegët kryetarët e grupeve parlamentare të ndalen në nivelin e mbështetjes së rezolutës dhe këtu nuk u mbajt ajo, prandaj edhe unë nuk do ta mbaj dhe do t'i them disa fjalë përtej mbështetjes së rezolutës. E kam një pyetje:

Sa lojëra të fatit, sa kazino duhet t'i hapë një qeveri për t'u quajtur "Qeveri e kazinove". Për shembull Qeveria e koalicionit PAN me kryeministër Haradinaj në 2018 ka licencuar 4 qendra të lojërave të fatit, ndërsa deri në vitin 2017 diku 42. Sa duhet të hapësh, të licencosh, t'u japësh leje, t'i tolerosh pa leje, për t'u quajtur "Qeveri e kazinosë", 42 apo 4? Prandaj, mirë që jemi bërë bashkë rreth nevojës për ta luftuar këtë dukuri negative, por të jeni të sigurt që kjo nuk do të hiqet si me shkop magjik telashi i kumarit, siç thotë populli. Përgatituni që këtë dukuri ta luftoni pastaj në vendet ilegale, e ekstra ilegale. Sepse, nëse deri tash ka pasur ilegale, në kuptimin e jashtëligjshëm pranë shkollave, tash nëpërmjet këtij vendimi ne vetëm do t'i detyrojmë të zhvendosen. Të zhvendosen nëpër shtëpi, nëpër ferma, a ku ta di unë... e keni parë?

Besoj se mjafton t'i hidhet një sy historisë së kazinove dhe të lojërave të fatit në vendet ku ato i kanë rregulluar me ligj dhe do ta shihni se duke i ndaluar nuk i ke hequr, sepse po krijohet iluzioni që nga momenti kur ne këtu e marrim një vendim, burrat dhe gratë e dheut, e kemi zhdukur problemin e lojërave të fatit. Jo, përkundrazi, ai do të vazhdojë të mbetet në fatin tonë dhe ne duhet të bëhemi gati që ta luftojmë atë në njërin anë që të mos e vazhdojë punën në forma vërtet tashmë ilegale, sepse njerëzit që fatkeqësisht kanë krijuar varësi, siç u tha edhe nga kolegu Topalli, për 20 vjet është krijuar një brez i njerëzve që kanë krijuar varësi, ata do ta kërkojnë atë ku është e ku s'është. Pra, përgatituni që të gjeni ilaç edhe për këtë, sepse vrasje ka pasur edhe më herët, të gjithë e dimë, dhe ka pasur lajme në televizione e portale nëpër kazino, rrahje... e kjo është ajo që prodhojnë këto lloj lojërash të fatit, në veçanti kazinotë.

Le të ndalemi pra tek ajo që jemi marrë vesh që ta mbështetim rezolutën dhe ta mandatojmë Qeverinë që t'i marrë masat e duhura, por gjithsesi në një proces të ardhshëm, Kuvendi e Qeveria duhet të bëhen bashkë për ta rregulluar këtë çështje me ligj. Nëse keni kapacitete për ta mbajtur nën kontroll, nëse jo atëherë duhet të ndërtojmë kapacitete për ta luftuar atë edhe kur është e ndaluar me ligj. E dimë pak a shumë historinë e prohibicionit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk është se e ka pas zgjidhur problemin e alkoolit. Të jemi të vetëdijshëm se duke i marrë këto vendime, nuk e kemi zgjidhur problemin.

Unë në emër të Nismës i jap mbështetje kësaj dhe në procesin e ardhshëm, edhe në grup parlamentar, edhe në Qeveri, nëpërmjet ministrave, do ta japim kontributin tonë që lufta kundër këtij fenomeni të jetë e vërtetë, e njëmendtë dhe jo vetëm sa për të thënë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga 6+, zonja Duda Balje, urdhëro!

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Poštovani poslanici,

Parlamentarna Grupa 6+ će naravno podržati ovu inicijativu, i svaku aktivnost za usvajanje ove rezolucije.

Iskreno mislim da je borba protiv kazina na Kosovu započela još u prethodnom mandatu, kada smo u okviru Komisije za budžet i financije zajedno sa gospodinom Naserom Osmanijem posetili veliki broj kazina koje su bili na Kosovu i situacija koja je tada bila, mislim da se ništa nije promenila ni do dana današnjeg. Naravno da predstavljaju veliki rizik i za pojedinca koje se bavi tim stvarima, za njihovu porodicu, za zajednicu, kao i za celu državu. Rizik od siromaštva i ostali rizici koji mogu nastati od velike aktivnosti kazinoa u maloj državi kao što je Kosovo posledice mogu biti vrlo opasne, i zbog toga je Parlamentarna Grupa 6+ odlučila da podrži ovu inicijativu i naravno rezoluciju za zatvaranje kazina i stvaranje novog zakona za igre na sreću. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në fakt, grupet parlamentare e kanë vendosur pothuajse pa debat, po zonja Balje e përmendi z. Osmanin, pastaj edhe i kanë vizituar. Do t'ia japë fjalën edhe Islam Pacollit, pastaj shkojmë te përfundimi nga kjo pjesë e rezolutës. Zoti Osmani, fjala për ju!

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Thjesht, isha në dilemë e të flas a jo, po mendoj që përsëri më mirë të mbetem vetëm te shefat e grupeve. Po i them veç nja dy-tri fjalë, meqenëse jam marrë goxha shumë me këtë çështje. Në vitin 2014, normalisht me iniciativën e Komisionit për Buxhet dhe Financa, ku është bërë monitorimi i zbatimit të ligjit në praktikë, atëherë Administrata Tatimore i ka mbyllur diku 457 pika të lojërave të fatit.

Po e shoh që deputetët nuk kanë të dhëna të sakta, manipulojnë me shifra. Nuk i di arsyet. Deputeti mund të ketë qasje në dokumente, dhe para se të flasë publikisht duhet të jetë më precizë. Ka vetëm nëntë kompani të lojërave të fatit, as 36, as 46, as 100. Se ato pastaj shtrihen, kanë shumë pika. Një kompani mund t'i ketë 200-300 pika dhe kjo pastaj e bën krejt këtë absurditet që po ndodh te ne. Ka diskutime të ndryshme, po i shoh edhe këta veç kanë filluar të ndahen "ne edhe ata", pozitë dhe opozitë të kolegut tim Topalli, por është një çështje shumë sensitive dhe deputeti duhet të jetë i kujdesshëm, sepse pikësëpari ka të bëjë me familjen dhe familja e shëndoshë është themeli i çdo shoqërie.

Pas hulumtimeve të cilat i kemi marrë nga Policia dhe gjykatat, lojërat e fatit janë shkaktari më i madh i divorceve në Kosovë. Janë problemi më i madh i ngatërresave në familje ndërmjet fëmijëve dhe prindërve, edhe ndërmjet vëllezërve, borxhet e ndryshme, shantazhet për kthimin e atyre borxheve. Krejt janë këto probleme që domethënë e rëndojnë shoqërinë tonë, sidomos në këtë situatë të rënduar ekonomike, kur ne po kemi telashe të tjera. Por ajo çka duhet theksuar që tendenca e rritjes së lojërave të fatit në Kosovë në muajt e fundit rrjedh pas vendimit të kryeministrit të Shqipërisë që t'i mbyllë ato dhe hapja e derës që ata të vijnë në Kosovë, që faktikisht edhe nëpër fshatra kanë filluar të lulëzojnë, është një dukuri për të cilën deputeti dhe Parlamenti duhet të ndërmarrin diçka. E respektoj shumë vullnetin e deputetëve dhe grupeve parlamentare që më në fund janë bërë bashkë. Ju rikujtoj që më 2014 më keni lënë fikall vetë, pos mediave, dhe telasht pastaj kanë buruar nga ato më të paparaparat.

Prandaj, unë konsideroj që shteti ka përgjegjësi, kanë përgjegjësi edhe institucionet e shtetit që shoqërinë kosovare ta ruajnë, që ta ruajë familjen e mirë shqiptare. Lojërat e fatit sjellin dukuri të këqija, prandaj ky vendim për pezullimin dhe ndryshimin e ligjit është më se i domosdoshëm dhe në kohën e qëlluar, pikërisht kur tani kur këto dukuri po përcillen edhe me akte tragjike, të cilat i kemi të pranishme.

Unë e falënderoj pas kaq viteve, edhe shefin e Grupit të LDK-së, Hotin, edhe të Vetëvendosjes, po edhe këta të tjerët që i janë bashkëngjitur që së bashku ta marrim një vendim të tillë, që të mos mbetet përgjegjësi e individit, sepse pastaj telashet janë të paparashikuara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ta përfundojë edhe Islam Pacolli, dhe s'ka tjetër deputet. Jemi drejt përfundimit, pastaj ministri e jep një fjalë. Unë vetëm do ta bëj një sqarim procedural.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryetar!

Kolegë të nderuar deputetë,

Media,

Me të vërtetë është si hap i qëlluar dhe pa u përfshirë në debatin e rezolutës, ne si AKR e mbështetim, por kisha dashur të shtoj që këto lojëra s'ishte dashur të jenë fare, për arsye që këto nuk e avancojnë, nuk e edukojnë, nuk e pasurojnë shoqërinë tonë, por vetëm e varfërojnë dhe sjellin kriza dhe natyrisht po e shihni të gjitha këto ngjarje, të cilat nuk i dëshiron askush. Ajo për çka dua t'i përgëzoj të gjithë deputetët këtu, së paku me deklaratimet që i dëgjova, që e përkrahin të gjithë dhe ne të jemi unikë dhe t'i largojmë menjëherë dhe shpresoj që këto të mos kthehen asnjëherë më në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Debati ka përfunduar. S'ka deputetë të lajmëruar në sallë. Ministri i Financave, z. Bedri Hamza e ka kërkuar fjalën nga Qeveria.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Është një temë jashtëzakonisht e rëndësishme dhe ka fituar në rëndësi, sidomos me ngjarjet e fundit. Sa i përket kësaj veprimtarie, edhe në kuadër të Reformës të Agjendave Evropiane 2016-2018, është marrë obligim nga institucionet e Kosovës, përkatësisht më 9. 11. 2016 që Ligji për lojërat e fatit të plotësohet dhe të ndryshohet.

Koncept-dokumenti është hartuar në Qeveri dhe ne jemi të gatshëm që qysh të vendosë Kuvendi, të vijmë në afatin sa më të shkurtër të mundshëm, me propozim në Kuvend, apo nëse Kuvendi vendos që ligji në rrugë më të shkurtër, pasi rruga nëpërmjet Qeverisë i ka disa hapa që duhet respektuar, ne jemi të gatshëm ta japim kontributin tonë edhe nëpërmjet Kuvendit. Dhe jemi të gatshëm që cilido prej këtyre tri opsioneve, apo ndonjë opsion tjetër, të jetë në konsideratë, ne ta mbështetim dhe ta përkrahim.

Nëse Kuvendi vendos që të kemi një hartim të ligjit, i cili do ta rregullojë këtë fushë në përputhje të plotë me direktivat e BE-së, ne e përkrahim. Nëse Kuvendi rekomandon që të silllet një ligj, i cili lejon ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit vetëm në lokacione jashtë qytetit, lokacione të pabanuara, e përkrahim edhe këtë opsion. Por, nëse ju, deputetë të nderuar të Kuvendit,

vendosni dhe jepni rekomandimin tuaj që të mbyllen të gjitha lojërat e fatit me ligj, i cili do të propozohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ne e përkrahim. Do të thotë, për cilindo prej opsioneve për të cilat përcaktohet Kuvendi, ne jemi për.

Megjithatë, nuk duhet harruar faktin se organet zbatuese të ligjit nuk është se nuk e kanë bërë punën e vet. Sigurisht se gjithmonë ka vend për më shumë. Po jua japim vetëm disa të dhëna për vitin 2018. Kam dëgjuar që shpeshherë në Kosovë flitet për kazinotë. Në Kosovë asnjë kazino nuk është e licencuar. Nuk ka kazino në Kosovë. Dogana dhe ATK-ja, vetëm vitin 2018 kanë konfiskuar 270 copë aparate, 400 mijë lojëra... Janë shqiptuar 185 gjoba për pika basti të palicencuara. Me kundërvajtje doganore, më 2018 janë trajtuar 280 raste dhe janë shqiptuar gjoba prej miliona eurove prej Doganës dhe Administratës Tatimore. Sigurisht se organet zbatuese të ligjit, në këtë rast edhe Dogana, edhe ATK-ja, shumë raste i kanë përcjellë edhe me kallëzime penale.

Unë e mbështes dhe e përkrah punën e organeve zbatuese të ligjit, edhe të Doganës, edhe të ATK-së, edhe të Policisë së Kosovës. Besoj që ata e kanë në konsideratë këtë çështje që t'i kryejnë obligimet e veta.

Prandaj, të nderuar deputetë, i nderuar kryetar i Kuvendit, Nëse vendos Kuvendi që ligji të procedohet nëpërmjet Qeverisë, pasi që koncept-dokumenti ka kaluar, në formën që e kërkon Kuvendi ligjin, në atë formë ne do ta sjellim në Kuvend, në afatin të cilin na e lejon, në afatin më të shkurtër të cilin na e lejon Rregullorja për procedimin e ligjeve. Rruga më e shkurtër është ligji të sponsorizohet nëpërmjet Kuvendit dhe komisioneve përkatëse të Kuvendit. Është në autoritetin e Kuvendit, për cilindo që pozicionohet. Ne si Ministri e Financave do të jemi në dispozicion që ta japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Zoti Kurteshi, debati ka përfunduar. Ju kisha lutur që të shkojmë në vendimmarrje. Unë po e rihap edhe një formë, veç pak! Çka ke vërejtje ti? Jo, jo, tash vetëm pak!

Zoti Sami Kurteshi, se nuk po e dëgjojmë, po thotë “Kuvendi i Republikës së Kosovës, deputeti i Kuvendit e ka të drejtën e fjalës”. A jeni normal, a nuk jeni? Kështu unë do t'i tregoj zotit Kurteshi që është e vërtetë që e ka të drejtën e fjalës, por jo të abuzojë me Kuvendin kur dëshiron, për faktin se e kemi një Rregullore të cilën duhet respektuar. Edhe ju e dini, ju e dini në bazë të Rregullores, unë e mbylla debatin. A ishte kështu? Edhe a e lashë të hapur çdoherë që kush dëshiron të bisedojë? Ju kisha lutur, ju kisha lutur, ka të bëjë me propozuesin e seancës. Ne jemi duke folur para publikut. Në qoftë se dëshirojmë... Po zërin e madh e ke o Sami, po shumë po bërtet!

(Reagime nga salla)

Ose tash po më vjen keq, kam respekt për Samiun, por ndërmend njëherë s'e kam t'ia jap fjalën pa u ndal. Sami ndalu, se po flet shumë, të lutem, me respekt. Zoti Kurteshi, qetësohu pak! Vetëm pak! Jo, s'po bëj asgjë. Zoti Kurteshi, a ka mundësi veç një minutë? Më shumë po flet ti se unë në mikrofon.

Vetëm pak! Të mos ia humbim hijeshinë, zoti Kurteshi. Tash, a ka mundësi veç një minutë! Ne jemi para një vendimmarrjeje, e tash qytetarët e Republikës së Kosovës do ta shohin se a e kemi seriozisht këtë çështje, apo është vetëm sa për ta hedhë hi para syve. Sido që të jetë, kështu është: Lojërat e fatit funksionojnë sipas Ligjit nr. 04/L-080 për lojërat e fatit të vitit 2012, proceduralisht po dua ta sqaroj. Andaj më përcillni, grupet parlamentare, të nderuar kolegë deputetë, mbyllja e tyre duhet të bëhet vetëm me nismë ligjore. Do të thotë, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-080 për lojërat e fatit, i cili mund të propozohet nga Qeveria apo deputetët, komisionet e Kuvendit. Do të thotë, kështu është. Ka një nismë ligjore, e cila mund të jetë nga Qeveria, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për lojërat e fatit, e mundëson miratimin më të shpejtë të ligjit, nën një. Nën dy, është nisma ligjore nga vetë ne deputetët, komisionet e Kuvendit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lojërat e fatit, në aspektin procedural merr më shumë kohë. Në qoftë se ne e kemi vendosur, jemi seriozë të marrim vendim, kjo varet nga ajo çfarë do të jetë rezoluta.

Unë kisha dëshiruar që propozuesi të jetë këtu. Ne ta përcaktojmë që brenda 45 ditësh, Qeveria ta sjellë, edhe ta përfundojë, pastaj pas 45 ditësh Kuvendi ta mbajë edhe një seancë, dhe të shikohet a po i mashtrojmë qytetarët, apo me të vërtetë po duam ta kryejmë këtë punë deri në fund. Të jemi të sinqertë para qytetarëve, boll i kemi mashtruar me seanca të jashtëzakonshme. Nëse doni t'i kryejmë, i kemi 45 ditë, ia vëmë vetes afat publikisht para qytetarëve, ua japim fjalën për 45 ditë, ministri e dha fjalën se mund ta sjellë. Ne kemi kaluar këtu edhe për një ditë proceduralisht. Kjo vendoset prej juve. Urdhëroni...!

Avdullah Hoti e ka fjalën. Po, duhet të kryhet.

AVDULLAH HOTI: Të faleminderit, kryetar!

Mendoj që rezoluta që është dorëzuar së bashku me kërkesën e protokolluar në Kuvend, është e qartë dhe ka marrë mbështetjen e të gjitha grupeve parlamentare, sot edhe nga AAK-ja e Nisma.

Pika e (1) parë e rezolutës e thotë qartë: Qeveria menjëherë ta pezullojë aktivitetin e të gjitha kazinove dhe lojërave të fatit deri në plotësim-ndryshimin e ligjit. Pra, ne si Kuvend nuk mund ta bëjmë këtë. Është në autoritetin e Qeverisë ta bëjë këtë çështje.

Dhe e dyta, nëpërmjet kësaj rezolute ne sot dakordohemi sot që ta mandatojmë Komisionin Parlamentar për Buxhet dhe Financa si Komision Funkcional, ku janë të përfaqësuara të gjitha partitë, që të nisë procedurat për nxjerrjen e ligjit të ri dhe t'ia sjellë Kuvendit ligjin e ri, ku mes

tjerash, të gjitha llojet e lojërave të fatit të pezullohen për një periudhë 10-vjeçare, brenda një muaji.

Mendoj se rezoluta është e qartë. E ka marrë mbështetjen e të gjitha grupeve parlamentare, sepse e kemi menduar edhe aspektin e Rregullores së Kuvendit dhe procedurat tjera që duhet të ndiqen.

Unë ju kërkoj që këtë ta nxjerrim në votim. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar kryetar i grupit parlamentar, e kemi një sqarim, i cili duhet të jetë procedural. Në vendin ku jeni ju është marrë ky vendim për këto lojëra të fatit. Zoti Osmani e qartësoi shumë sesi ka mbetur krejtësisht i vetëm më 2014.

Situata është se për vendimet të cilat i merr Kuvendi, Qeveria nuk ka të drejtë aq lehtë të marrë përgjegjësi, se mund të marrë konsekuenca.

Në qoftë se e kemi seriozisht, ne si Kuvend mund që brenda 45 ditëve ta kryejmë dhe nuk sanksionohemi nga askush, po u tregojmë edhe qytetarëve se po mendojmë për ata.

Në qoftë se e kemi pasur ndërmend veç ta kryejmë këtë rezolutë, e kryejmë si shumë të tjera dhe mbetet këtu.

Po vendimmarrje në suspendim, ja ku e ke edhe ministrin, derisa ne kemi marrë vendim, ne e kemi obliguar ministrin aktual dhe juve përpara që të respektohen dhe të licencohen ato. Nuk është faji, tash të them, drejtpërdrejt i ministrit përkatës.

Do të thotë, a po marrim vendim që brenda 45 ditëve, rregulloje rezolutën për pesë minuta, e votojmë të gjithë. Nisma ligjore kalon në Kuvend, 45 ditë e kryejmë definitivisht dhe i shpëtojmë shumë familje. Dhe pastaj ajo që duhet të legalizohet, e legalizon ky Kuvend.

Ajo si e tha Billali, nuk e quajmë ilegale hiç.

Çka duhet, diku larg nëpër male e nëpër kufi, siç e bën bota e civilizuar, por jo të afrohen te shkollat.

A ka mundësi të përcaktohet pak më qartë rezoluta me grupet parlamentare? Vetëm pak, e vë në votim po nuk ka funksionalitet. Ngase nuk mund ta suspendojë... Urdhëro, ministër! Pse kur ka marrë Kuvendi, qysh merr Qeveria. Urdhëro, ministër!

Ne po flasim me qëllim që të kryejmë punë, e jo t'i manipulojmë qytetarët. Jo, jo, për t'i manipuluar mjaft ka qenë.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Unë po e kuptoj qëllimin e mirë të kësaj iniciative dhe të këtij debati. Po e bëj një sqarim; kazino të licencuar nuk ka, nëse ka ilegale, organet e rendit duhet të merren me të.

Mirëpo, diçka që është e lejueshme me ligj, nuk mund të ndryshohet me akt nënligjor me vendim. Nuk e ka fuqinë ligjore më të madhe vendimi i Qeverisë se ligji. Andaj, këtu ka juristë të respektuar në Kuvend. Le të më tregojnë sesi diçka që është lejuar me ligj, ka mundësi që e njëjta të suspendohet me akt nënligjor?

Prandaj, qëllimi është që ne ta adresojmë këtë punë, një diçka që është e rregulluar me ligj, të rregullohet me ligj. Nëse një jurist mund të më tregojë se cila është rruga, që diçka që është lejuar me ligj dhe mund të suspendohet me akt nënligjor, cili është ai nen i ligjit që e lejon që një çështje e caktuar të rregullohet me një akt nënligjor, i cili është vendim, rregullore, udhëzim apo çka do qoftë?

Prandaj, do t'ju lusja që ta aprovoni një rezolutë, e cila e adreson këtë punë dhe jo të bëhet një rezolutë, e cila pastaj në implementim do të ketë probleme legale.

KRYETARI: Kështu, nuk do ta lejoj që të shkojë në mënyrë manipulative kjo seancë, ngase qëllimi nuk është i sinqertë. Nuk është që të ndalen lojërat e fatit, po vetëm të hapen dhe të mbyllën me sot. Kështu nuk do të jetë.

Unë do ta ftoj çdo grup parlamentar që të ma autorizojë një jurist publikisht dhe të flasë para qytetarëve. Le të jetë i sinqertë apo manipulues, si mund të suspendohet dhe a e kemi kryer punën sot.

Në qoftë se kemi vendosur që ta kryejmë punën si Kuvend, do ta kryejmë kësaj radhe për gjithëherë. Jo t'i rrejëm qytetarët. Kjo është. LDK-ja, ma jep një jurist dhe le të ma trajtojë juridikisht, tani shkojmë në vendimmarrje. Pastaj shkojmë edhe PDK-ja. Manipulime nuk do të ketë.

Cili prej juristëve të LDK-së, ose kryetari i grupit parlamentar, ka qenë ministër i Financave. A ka pasur të drejtë që ta marrë vendimin që ta suspendojë dhe ta kryejë këtë punë. Ne po flasim para qytetarëve, a jemi të sinqertë, apo jo.

Si kryetar i Kuvendit nuk do të ec më tutje, në mënyrë që veç të manipulohen dhe pas tre muajsh të harrohet kjo punë. Për 45 ditë e kryejmë këtë punë në qoftë se e keni përnjëmend, siç thotë populli. Të vendoset për 45 dhe i mbyllim të gjitha.

Për një javë, mirë e ka zonja Gaxherri, shumë mirë e ka. Për një javë ditë, ne e kemi kaluar për një ditë leximin e parë dhe të dytë. Zgjidhni e merrni! Në qoftë se na e kanë zënë kazinotë çdo parti politike, ndopak secili ditën flasim këtu, po natën...

10 minuta pauzë!

Grupet parlamentare le të konsultohem. 10 minuta pauzë! Vetëm largimi i deputetëve nga seanca do të thotë bojkot i këtij vendimi. Veç t'i iket përgjegjësisë dhe kjo le të dihet publikisht.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
Administrata, ju lutem i thërrisni deputetët që të kthehen në Kuvend.
Është harmonizuar teksti i projektrezolutës nga grupet parlamentare. Shkojmë drejt votimit.
Vetëm le të kthehen deputetët në Kuvend.

* * *

Administrata ju lutem, gjendjen për arsye se... Zoti Hoti, a po e lexoni projekt-rezolutën menjëherë, ndërkohë vijnë deputetët dhe i zënë vendet.

Në qoftë se je gati, ju kisha lutur ta lexoni projektrezolutën. Kur do që je i gatshëm. Në qoftë se je i gatshëm, menjëherë. Zotëri Hoti është duke e lexuar projektrezolutën. Deputetët le të ulen nëpër vende, ju lutem!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Pas konsultimeve me kryetarët e grupeve parlamentare, unë i propozoj tani këto ndryshime në propozim-rezolutë:

1. Qeveria t'i nisë procedurat ligjore për pezullimin e aktivitetit të të gjitha llojeve të lojërave të fatit deri në plotësim-ndryshimin e ligjit përkatës dhe
2. Qeveria brenda 30 ditësh të sjellë në Kuvend ligjin e ri që i ndalon të gjitha llojet e lojërave të fatit për një periudhë 10-vjeçare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi 73 deputetë, përgatitemi për votim! Regjia dhe deputetët përgatiten për votim për projekt-rezolutën e lexuar nga zoti Avdullah Hoti.

Në harmonizim me të gjitha grupet parlamentare, votojmë tash!

Kanë votuar 73 deputetë, 73 për. Miratohet projekt-rezoluta. Edhe një, 74 deputetë, zonja nënkryetare Aida Dërguti ka votuar po ashtu për.

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance të jashtëzakonshme. Mirupafshim në seancat e radhës!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë